

Data 28.12.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Sherbim i mirembajtjes së certifikimeve dhe auditim vjetor ,(Cilesia ,Mjedisi,Siguria në vendin e punës)
Ref-92445-12-28-2023

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79900000-3 dhe 90700000-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.988.000 (një milion e nentëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) leke pa **TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertes ekonomike sipas Shtojcës 1 dhe 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pike plotesohet me dorezimin e *Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet nënenin 26, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (c).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2020, 2021, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55 pika 4b ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4. Kërkesa te tjera

KAPACITETI TEKNIK – ISO, SIGURIA PUNE, MJEDISI

1. Operatori Ekonomik duhet te kete te regjistruar te pakten 6 (gjashte) punonjes ne muajin e fundit, nga keta te pakten 2 konsulente qe te vertetojne qe angazhohen, jane te kualifikuar dhe kane eksperience ne hartimin e dokumentacionit, implementimit dhe asistences per standardet ISO 9001, 14001, 45001 dhe SA 8000. Kjo e vertetuar nga deshmi perkatese.

Ky kriter plotesohet nepermjet deklarimit ne Shtojcen 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit dhe dorezimit te listepageses se fundit per muajin Nentor 2023.

2. Operatori Ekonomik te kete te pakten dy persona te diplomuar per inxhinieri IT/Elektronike/Elektrike dhe me kualifikime apo trajnime te ndryshme mbi standardet ISO dhe Ceshtjet e Sigurise e Shendetit ne Pune. Kjo e vertetuar nga deshmi perkatese.

3. Operatori Ekonomik duhet te kete dy nga konsulentet e tij qe te kene pervoje si Lead Auditor per auditimin e standartit dhe versionit te fundit te ISO 9001, 14001, 45001. Per te deshmuar kete pike konsulenti duhet te paraqesi vertetim/deshmi nga nje trupe certifikuese e Akredituar per keto ISO dhe deshmi perkatese si Lead Auditor.

4. Operatori Ekonomik gjithashtu te kete pjese te stafit te tyre te brendshem apo te jashtem me kontrate nje ekspert ne fushen e auditimeve dhe konsulencave te mjedisit, ky i fundit te jete

a. i pajisur me certifikate si Ekspert Mjedisor

b. Vertetim nga nje trupe certifikuese e akredituar per ISO 14001, qe eshte pjese e kesaj trupe si Lead Auditor per ceshtjet mjedisore;

c. Deshmi mbi trajnime dhe kualifikime mbi mjedisin, mbrojten, vleresimi dhe ndikimin ne mjedis, etj. Certifikatat e leshuara si Lead Auditor per SO 14001 te jene te akredituara nga nje organ sipas ISO 17024, kombetare dhe nderkombetare.

5. Operatori Ekonomik duhet te vertetoje qe dy prej Lead Auditoreve te jene edhe pjese e nje trupi certifikuese te Akredituar sipas ISO 17021 dhe qe kryen auditime certifikimi per trupen per ISO 9001, 14001, 45001, si prove per kualifikimin e tyre duhet te paraqiten vertetime nga trupa certifikuese e akredituar per keto persona.

6. Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur dhe i certifikuar me sistemin e menaxhimit sipas ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013 Te katra certifikatat te jene te vlefshme dhe te leshuara nga nje OVK e akredituar per te treja standardet. Akreditimi i OVK

duhet te njihet nga DA e Shqiperise ose ent nderkombetar akreditimi i njohur ne Republiken e Shqiperise.

7. Operatori Ekonomik ofertues duhet qe aktivitetin e konsulences dhe certifikimi te standardeve ISO ta kete pjese te objektit te paraqitur ne QKB. Gjithashtu te jete i Licensuar nga QKL sipas licences X.2.B per Trajnime dhe formim professional per keto tema:

- a. mbi standardet ISO 9001, 14001, 45001,
- b. mbi pergjegjesin dhe koordinimin e shendetit e sigurise ne pune
- c. mbi ndihmen e pare dhe higjenen ne pune.
- d. mbi mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, evakuimet, pajisjet dhe fikset e zjarrit, etj

Kjo duke e vertetuar me aneksin dhe miratimin nga Agjensia Kombetare e Aftesive dhe Pune.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 germa a dhe b dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij.